

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
SENATI AKADEMIK

Nr. 654/3 prot.

Vlorë, më 21 . 05 .2018

VENDIM

Nr. 21, datë 08.05.2018

**PËR PROCEDURËN E ANALIZËS DHE VLERËSIMIT TË PYETËSORËVE TË
STUDENTËVE PËR CILËSINË E MËSIMDHËNIES PËR LËNDËT E ÇDO
PROGRAMI STUDIMI NË UNIVERSITETIN "ISMAIL QEMALI", VLORË**


Mbështetur në nenin 38, pika 1, shkronjat j, k, nenin 103 të ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", urdhrin të Rektorit nr.21, datë 22. 02. 2018 "Për organizimin e pyetësorit studentor për cilësinë e mësimdhënies për lëndët e çdo programi studimi", dhe ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008, ndryshuar me ligjin nr. 48/2012, ndryshuar me ligjin nr. 120/2014 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", Senati Akademik në mbledhjen e datës 08.05.2018

VENDOSI:

1. Të miratojë procedurën e analizës dhe vlerësimit të pyetësorëve të studentëve për cilësinë e mësimdhënies për lëndët e çdo programi studimi në Universitetin "Ismail Qemali", Vlorë si më poshtë:

Faza e parë: *Plotësimi i pyetësorëve prej studentëve; Kohëzgjatja: të paktën tre javë përpara sezonit të provimeve.*

- Me urdhër të Rektorit, formulari i pyetësorit të studentëve, miratuar me Vendim Senati nr. 52, datë 20.04. 2017, hidhet në sistem në Sektorin e Anketimeve.
- Në fillim të sezonit të provimeve, çdo student plotëson pyetësorin online nëpërmjet adresës personale në sistemin elektronik të universitetit. Studentët janë të detyruar ta plotësojnë pyetësorin përpara provimit përfundimtar të lëndës përkatëse. Rezultatet e këtij pyetësori do të publikohen pas përfundimit të sezonit të provimeve. Gjatë gjithë procesit të plotësimit të pyetësorëve, përgjegjësi i Sektorit të Shërbimeve Teknologjike dhe Zhvillimit do të ketë akses me qëllim monitorimin teknik, por pa ndërhyrë në përmbajtjen e pyetësorëve. Pas përfundimit të procesit të plotësimit të pyetësorëve, Përgjegjësi i



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
SENATI AKADEMIK


Sektorit të Shërbimeve Teknologjike dhe Zhvillimit ia përcjell të dhënat e pyetësorëve Njesisë së Brendshme të Sigurimit të Cilësisë dhe Vlerësimit Institucional.

Faza e dytë: *Vlerësimi i pyetësorëve të studentëve; Kohëzgjatja: dy muaj*

- Brenda dy muajve, pas përfundimit të procesit të plotësimit të pyetësorëve, Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë dhe Vlerësimit Institucional përpilon raportin e detajuar të analizës dhe rezultateve të pyetësorëve, të cilët ia përcjellin Drejtorit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Zhvillimit Institucional dhe Zv/Rektorit për Kërkimin Shkencor dhe Zhvillimin Institucional, të cilët e shqyrtojnë, analizojnë dhe përgatisin projekt-propozimet për rritjen e cilësisë.
- Raporti i detajuar i analizës dhe rezultatet e pyetësorëve duhet të përmbajnë të dhëna të sakta për departamentin, fakultetin, programin e studimit, lëndën përkatëse që është vlerësuar, numrin e pjesëmarrësve, rezultatet konkrete për secilën lëndë, pyetësorët e pavlefshëm dhe çdo të dhënë tjetër me rëndësi për cilësinë e mësimdhënies.
- Pas analizës së raportit, Drejtori i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Zhvillimit Institucional dhe Zv/Rektori për Kërkimin Shkencor dhe Zhvillimin Institucional ia përcjellin raportin dhe projekt-propozimet për rritjen e cilësisë së programeve të studimit Rektorit.
- Rektori pas shqyrtimit dhe miratimit, e përcjell raportin së bashku me projekt-propozimet pranë drejtuesve të njësive kryesore me qëllim diskutimin dhe dhënien e propozimeve të mëtejshme.

Faza e tretë: *Feedback-u; Kohëzgjatja: 1 muaj*

- Drejtuesit e njësive kryesore iu përcjellin drejtuesve të njësive bazë pjesën respektive në raportin e analizës së pyetësorëve.
- Drejtuesit e njësive bazë vendosin në dijeni për rezultatet e pyetësorëve anëtarët e stafit akademik.
- Brenda 15 ditëve drejtuesit e njësive kryesore thërrasin për mbledhje dekanatet përkatëse me qëllim diskutimin e rezultateve, evidentimin e praktikave të mira dhe përmirësimin atje ku është e mundur. Nga kjo mbledhje, dekanati del me një material përfundimtar së bashku me projekt-propozime, të cilin ia përcjell Rektorit.
- Rektori pas marrjes së materialeve prej njësive kryesore thërret brenda 15 ditëve mbledhjen e Rektoratit, në të cilën diskutohet raporti përfundimtar së bashku me propozimet si dhe përpilohet një plan masash me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

cilësisë në programet e studimit dhe mësimdhënie, të cilën ia përcjell Senatit për miratimin përfundimtar.

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Zv/Rektori për Kërkimin Shkencor dhe Zhvillimin Institucional, Drejtoria e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Zhvillimit Institucional, drejtuesit e njësive kryesore dhe drejtuesit e njësive bazë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

Prof. Dr. Roland ZISI



